



AIDA

ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY




invest in Albania

NEWSLETTER

PRILL - QERSHOR 2020

SHESHO KURBËN!

RESPEKTO MASAT PARANDALUESE



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju kujton që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm dhe të respektojmë masat parandaluese kundër COVID-19. Sot më shumë se çdo ditë ka nevojë për solidaritet.

Revista e AIDA-s, newsletter, është botim i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

AIDA ka si qëllim që me anë të këtij botimi të informojë në mënyrë të vazhdueshme publikun dhe bizneset për aktivitetin e agjencisë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), sjell për publikun, biznesin dhe palët e interesit, revistën periodike Newsletter për periudhën Prill – Qershor 2020.

Në këtë Newsletter do të gjeni informacione rreth aktivitetit të Agjencisë për tre mujorin e dytë të vitit 2020, takimet e organizuara duke respektuar rregullat e vendosura nga Qeveria Shqiptare në këtë periudhë pandemie, webinarët e zhvilluara, rubrikat e publikuara në faqen web, përditësime dhe informacione të rëndësishme mbi sipërmarrjen, etj.

AIDA në përshtatje edhe me situatën e krijuar nga COVID -19 ka vazhduar të jetë proaktive dhe në dispozicion me të gjitha shërbimet dedikuar bizneseve dhe palëve të interesit. Për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve AIDA ka lançuar rubrikën më të re në web të quajtur "COVID-19", një rubrikë e cila ka si qëllim aksesin në informacion dhe qarkullimin e këtij informacioni në një kohë sa më të shpejtë për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u informuar mbi Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve na vizitoni në:

✉ info@aida.gov.al 🌐 aida.gov.al 📞 +355 (0)42 251 001 🐦 @investinalbania
 📷 @aida__albania 📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency



AIDA TEAM | KONTAKT

email: info@aida.gov.al
 tel: +355 042 251 001
 web: www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në përshtatje me situatën e krijuar nga COVID-19, ju rikujton se ne vazhdojmë të jemi në dispozicion me shërbimet tona si më poshtë:

Dorëzimi i aplikimeve ose dokumenteve për statusin e investitorit strategjik, bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare.

Dokumentet e çfarëdollojshme përcillen përmes Postës Shqiptare, nëpërmjet adresës zyrtare të AIDA-s, info@aida.gov.al ose pranë zyrave të AIDA-s duke u lidhur më parë me stafin tonë.

Për çdo informacion, ju lutem vizitoni faqen web www.aida.gov.al dhe rrjetet tona sociale për përditësime.

AIDA Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ka në fokus promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues vendas, si edhe promovimin e potencialit turistik kombëtar.

Gjithnjë e më shumë AIDA po synon gjetjen e qasjeve të reja në funksion të përmirësimit të shërbimeve që ofron. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet objektivave konkrete të vendosura për vitin 2020 nga secila drejtori, duke ndërthurur punën e përbashkët profesionale si institucion drejt një qëllimi.

Më rendësi për punën e AIDA-s gjatë vitit 2020 është mbështetja konkrete ndaj biznesit vendas, thjeshtimi i procedurave për investitorët e huaj; vendosja e bashkëpunimeve të reja dhe të suksesshme me institucionet, në ndihmë të klimës së investimeve; përçimi i informacionit të përditësuar për investitorët e huaj dhe ata vendas; realizimi i disa "outreach campaign" në sektorët potencialë, realizimi i disa pyetësorëve për kompanitë që kanë investuar në Shqipëri për t'u njohur me nevojat e tyre për përmirësimin e klimës së biznesit.



invest in Albania



AIDA SI AMBASADORE PËR RITJEN E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI

Vizitë në kompaninë "Yura Corporation Albania" Fier, me rastin e 1 (një) vjetorit të investimit të kompanisë.

U zhvillua në qytetin e Fierit, ceremonia e inagurimit të fabrikës së kompanisë koreano-jugore Yura Corporation Albania. Kompania operon në sektorin e prodhimit të pjesëve të automobive, me një investim gjigand prej rreth 1 (një) miliardë lekësh.



Pjesë e ceremonisë së inagurimit ishte Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, Drejtori i AIDA-s Z. Sokol Nano, Ministria e Financave Znj. Anila Denaj, CEO i Kompanisë Yura Corporation Albania, Z. Lucas Nam, Kryetari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore.

Yura Corporation Albania ka deri më sot mbi 600 të punësuar dhe pritet të krijojë edhe 700 vende të reja pune vitin e ardhshëm, duke arritur një total prej 2000 punonjësish në vitin 2023. Ndërsa volumi i eksporteve të kompanisë parashikohet të mbërrijë në 100 milionë Euro brenda tre viteve.

Fjalën hapëse të ceremonisë e mori Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, i cili theksoi faktin se Yura Corporation Albania është një nga investimet më të mëdha ndërkombëtare dhe me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Z. Nano përmendi punën e bërë nga AIDA në ndihmë të kompanisë Yura Corporation Albania dhe të investitorëve të tjerë në vend, duke i ndihmuar që në hapat e parë të idesë së projektit dhe në vazhdim të implementimit të saj.



Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, në fjalën e tij u shpreh se: "Reformat e Qeverisë Shqiptare dhe vëmendja e shtuar e AIDA-s ndaj investitorëve kanë dyfishuar stokun e investimeve të huaja në vend në 2019, krahasuar me gjashtë vite më parë".



Kryeministri vlerësoi se: "Ky është një investim jashtëzakonisht i rëndësishëm për Fierin, për profilin që ka dhe fuqinë tërheqëse që krijon duke e bërë më të lehtë rrugën e thithjes së investimeve të tjera në fushën e prodhimit për automobilët". Z. Edi Rama shprehu se: "për ne ka shumë rëndësi që punonjësit të paguhen sa më mirë dhe përfaqësuesi i kompanisë më tregoi se rritja e pagave do të përshkallëzohet në bazë të përfitimit të përvojës. Në bazë të eksperiencës do të rritet me 30% dhe bazuar në rritjen e volumit do të rritet në mënyrë të arsyeshme".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila Denaj, vlerësoi punën e bërë deri më tani nga kompania Yura Corporation Albania, e mbështetur dhe nga AIDA si ambasadore për rritjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, duke synuar që trendi pozitiv i viteve të shkuara të vijojë dhe të rritet më shumë.



Rivitalizimi i pronave shtetërore, prioritet i AIDA-s

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s Z. Sokol Nano, vizitoi qytetin e Korçës në kuadër të identifikimit dhe promovimit të pronave shtetërore. Kjo vizitë u organizua me ftesë të kryetarit të Bashkisë Korçë Z. Sotiraq Filo.



Pronat shtetërore nuk duhet të flenë, por ato duhet të sillen në vëmendjen e investimeve për projekte të reja zhvillimi që ndihmojnë drejtpërdrejt zonën, qytetarët dhe biznesin, ky është qëllimi i AIDA-s, u shpreh Z. Nano gjatë takimit, proces në të cilin aktorët vendorë kanë një rol të rëndësishëm proaktiv.

AIDA asiston kompanitë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19

Zv/Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Belinda Ikonj, vizitoi kompaninë me kapital të huaj që tregton dhe eksporton në fushën e materialeve të ndërtimit dhe produkteve hidrosanitare. Kompania është asistuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, për përshtatjen e aktivitetit edhe në blerjet online. Mbështetje me politika efikase për sipërmarrjet e huaja dhe vendase për rimëkëmbjen sa më të shpejt të ekonomisë shqiptare, si dhe për të zhvilluar sa më shumë digjitalizimin e tregtisë sipas standardeve të BE-së.



Enterprise Europe Network (EEN)



AIDA, si lider i konsorciumit shqiptar të Rrjetit European të Ndërmarrjeve (EEN- Albania)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e koordinatores së projektit Enterprise Europe Network Albania (EEN-Albania), si edhe në kuadër të zbatimit dhe implementimit të këtij projekti, zhvilloi një takim me partnerët e konsorciumit shqiptar. Në këtë takim ishin pjesëmarrës katër përfaqësues nga institucione publike dhe private të konsorciumit shqiptar, i cili përbëhet nga: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë, Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen.



Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s Z. Sokol Nano, ndau me të pranishmit objektivat dhe prioritetet kryesore të projektit, mundësitë që rrjeti ofron për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare në gjetjen e partnerëve strategjikë dhe zgjerimin në tregje të reja, transferimin e teknologjisë, si edhe rritjen e aftësive konkurruese dhe inovative të tyre në tregun Europian dhe më gjerë. Në përfundim të takimit u dakordësua edhe për hapat dhe planin që duhet të ndiqet me qëllim implementimin dhe zbatimin e objektivave të projektit.

WEBINAR



AIDA në bashkëpunim me partnerin Expo City organizoi webinarin me temë “Industria Tekstile në Shqipëri dhe dinamikat gjatë dhe pas COVID-19”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me partnerin Exocity Albania, në datën 21 Maj, zhvilloi webinarin me temë “Industria Tekstile në Shqipëri dhe dinamikat gjatë dhe pas COVID-19”.

Gjatë webinarit në kuadër të këtij sektori, si një nga sektorët me rëndësi për ekonominë shqiptare sidomos në drejtim të punësimit, u diskutua mbi zgjidhje të reja alternative, pritshmëritë për të ardhmen, situatën e industrisë tekstile në tregjet ndërkombëtare, si edhe ndikimin që ka shkaktuar pandemia në mbarëvajtjen e sektorit.

Në panelin e diskutimit në këtë webinar, Znj. Desarta Rapushaj, eksperte e AIDA-s dhe EEN - Albania, theksoi rëndësinë e sektorit të tekstileve në ekonominë shqiptare kryesisht në eksport, rolin dhe kontributin që Agjencia ka ofruar në këto kohë pandemie nëpërmjet gjetjes së partnerëve të rinj, mënyrave inovatore të punës, si edhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të sektorit.



AIDA ka bërë vizibël shumë platforma virtuale me qëllim takimet B2B për sektorin e tekstileve. Qëllimi i këtyre takimeve është zgjerimi i partneriteteve, tregjeve të reja dhe për të ndarë ide dhe zgjidhje alternative pune në kohë pandemie. Gjithashtu u prezantuan edhe paketat financiare në mbështetje të bizneseve, aktiviteti i të cilave është prekur nga pandemia.



RUBRIKA | WEBSITE

Platforma “Business to Business”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), bëri publike këtë periudhë platformën B2B në ndihmë të NVM-ve. Platforma B2B është një rrjet aktiv i cili ofron mundësinë për bashkëpunime dhe investime të suksesshme midis bizneseve.

Platforma B2B që është e bashkëlidhur në faqen e AIDA-s është një mjet lehtësues, ku bashkëpunimet frytdhënëse dhe zgjerimi i kontakteve në botën e biznesit do të vazhdojë të jetë i mundur pa humbur më shumë kohë.

AIDA, ju fton të regjistroheni ose përditësoni të dhënat tuaja në platformën B2B, duke na kontaktuar në adresën zyrtare: info@aida.gov.al

Për t'u njohur me platformën B2B vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/b2b/>

PLATFORMA BUSINESS TO BUSINESS



Rubrika COVID-19

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, për t'ju ardhur në ndihmë bizneseve, prezantoi rubrikën më të re në web-in zyrtar: www.aida.gov.al “COVID-19”.

Në këtë rubrikë prezantohen iniciativat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për të përballuar situatën, informacione të përditësuara në lidhje me paketat financiare në ndihmë të biznesit, aplikimet për programet e mbështetjes së biznesit, projektet, nismat e tjera publike, si edhe lidhje e kontakte të rëndësishme.

Kjo rubrikë ka si qëllim aksesin në informacion dhe qarkullimin e këtij informacioni në një kohë sa më të shpejtë për një koordinim më të mirë mes palëve.

Për t'u njohur me informacionet e publikuara në këtë rubrikë vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/covid-19/>



COVID-19




PËRDITËSIME DHE INFORMACIONE

Kalendari i thirrjeve për projekte, webinarë dhe trajnime online për të gjithë sipërmarrësit

AIDA ka publikuar kalendarin e projekteve, webinarëve dhe trajnimeve online, i cili do ju shërbejë sipërmarrësve për t'i mbajtur të informuar për opsionet e tyre dhe praktikën më të mirë që mund të ndjekin për zhvillimin e biznesit gjatë periudhës së pandemisë dhe në vazhdimësi.

Vizitoni linkun më poshtë për t'u regjistruar në webinarët dhe thirrjet e ardhshme: <http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/covid-19/Webinare,%20trajnime%20dhe%20projekte%20p%c3%abr%20bizneset%20e%20vogla%20dhe%20t%c3%ab%20mesme.pdf>

Agjencia do të vazhdojë të identifikojë, mbështesë dhe informojë të gjithë sipërmarrësit mbi mundësi të reja për të mbështetur rritjen dhe zgjerimin e biznesit.



Njoftim mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ju informon mbi Ligjin Nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt” të ndryshuar”.

Ndryshimet dhe shtesat shtrihen në tri fusha kryesore që rregullohen nga Ligji Nr.108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar. Fushat të cilat kanë ndryshuar janë: politika e vizave; politika e qëndrimit dhe politika e punësimit të të huajve.

Për t'u njohur me ndryshimet më konkretisht në secilën nga fushat e mësipërme, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 25 mars 2020, vizitoni linkun:

<http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/ligji%20per%20investitoret%20e%20huaj.pdf?fbclid=IwAR3D-S6ulfgJ3mKS2IFhuhke5FJFw08xjiRc68iOMJBWYSFC7SHRfVJZQwU>

Inventari i nxitësve të investimeve në Shqipëri

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, për t'i ardhur në ndihmë palëve të interesit, ka hartuar një inventar të nxitësve të investimeve në vendin tonë.

Në këtë material do të gjeni informacion mbi të gjitha incentivat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare në mbështetje të biznesit vendas dhe të huaj, si dhe nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

Për t'u njohur me të gjithë informacionin në inventarin e nxitësve të investimeve në Shqipëri, vizitoni linkun në vijim: http://aida.gov.al/wp-content/uploads/pdf/Inventari_i_nxitesve_te_investimeve_ne_Shqiperi.pdf?fbclid=IwAR3ZeBIIVACGaHKG9kCdXMIjg5guOdaJSQDqv98WzAYRFARkqW15TO0-C-Q

Publikohet Akti Normativ Nr. 26 datë 10.06.2020 “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”

Akti normativ Nr. 26 datë 10.06.2020 “Për marrjen e masave të përkohshme për mbështetjen e sektorit të turizmit”, ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren në sektorin e turizmit, për agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe klientët e tyre, në ofrimin e një shërbimi udhëtimi, nga dita e shpalljes deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

Për më tepër informacion rreth këtij akti normativ klikoni linkun:

<https://qbz.gov.al/.../26/17488798-bc45-4e53-8ae3-4a800e31241a>

AKTI NORMATIV PËR SEKTORIN E TURIZMIT

PËR MARRJEN E MASAVE TË PËRKOSSHME PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT TË TURIZMIT

- PËRCAKTIMI I MASAVE TË VEÇANTA QË DO TË MERRNË NË SEKTORIN E TURIZMIT, PËR AGJENCITË E UDHËTIMIT, OPERATORËT TURISTIKË DHE KLIENTËT E TYRE, NË OFRIMIN E NJË SHËRBIMI UDHËTIMI
- MBËSHTETJA E SEKTORIT TË TURIZMIT DUKE OFRUAR NJË BALANCIM DHE SIGURI EKONOMIKE
- PARASHIKIMI NË MËNYRË TË DETAJUAR I RIMBURSIMIT PËR SHËRBIMET E PARAPAGUARA OSE TË REZERVUARA PËRPARA SHPALLJES DHE GJATË GJENDJES SË FATKEQËSISË NATYRORE
- DETYRIMI DHE AFATI I NJOFTIMIT NGA ANA E OPERATËVE TURISTIKË OSE AGJENCITË E UDHËTIMIT NDAJ AGJENCIVE/TRANSPORTUESVE/AKOMODUESVE OSE ORGANIZATORËVE TË PAKETAVE TË UDHËTIMIT/KLIENTIT
- DETYRIMI I RIMBURSIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT DHE/OSE PAKETËS SË UDHËTIMIT NË RAST SE NUK REALIZOHET SHËRBIMI
- PARASHIKIMI I VENDOSJES SË GJOBËS NDAJ OPERATËVE TURISTIKË OSE AGJENCIVE TË UDHËTIMIT, TË CILËT NUK I ZBATOJNË DETYRIMET E PARASHIKUARA NË KËTË AKT



SHFLETO BROSHURAT
E REJA TË AIDA-S

BOTIME

Broshura më e re e AIDA-s “Manuali i Investimeve Strategjike”

AIDA, ju fton të shfletoni broshurën më të re online “Manuali i Investimeve Strategjike” në versionin shqip dhe anglisht.

Në këtë botim online të broshurës, investitorët shqiptarë dhe të huaj të interesuar për të bërë biznes në Shqipëri, do të gjejnë të gjithë informacionin mbi ligjislacionin shqiptar të investimeve strategjike, sektorët strategjikë, aplikimi për statusin e investitorit strategjikë, procedurat administrative të investimeve strategjike, organet ligjzbatuese, bashkëpunimet ndërinstitucionale për vënien në zbatim të projektit dhe marrjen e statusit të investitorit strategjik.

Për t'u informuar mbi përmbajtjen e broshurës, vizitoni linkun: <http://aida.gov.al/manuali-i-investimeve-strategjike/>



“AIDA, GUIDE TO A
SUCCESSFUL BUSINESS”



NEWSLETTER

Prill - Qershor 2020

Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), në vitin 2019 arriti në vlerën e 1.08 miliardë euro dhe është rritur me 59 milion Euro (ose 5,7%) në krahasim me vitin paraardhës.

Shifra rekord prej 1.08 miliardë euro Investime të Huaja Direkte përfshin investimet në sektorin e energjisë, i cili është sektori që tërhoqi më shumë investime në 2019-n me 31% të totalit, pasuar nga industria nxjerrëse me 20% të totalit.

Stoku i IHD-ve në Shqipëri ka patur një trend rritës përgjatë periudhës 2014-2019 duke shënuar vlerën më të lartë në vitin 2019. Për sa i përket shpërndarjes së fluksit të investimeve në aktivitete të tjera, industria nxjerrëse, ndërtimi, aktivitetet financiare dhe të sigurimit, artet, argëtimi dhe çlodhja rezultojnë sektorë dominues në rritjen e kapitalit të investimeve për vitin 2019.

Shtetet që kanë investuar shifrat më të larta në Shqipëri janë Holanda dhe Zvicra përkatesisht në vendin e parë dhe të dytë, ndersa në vendin e tretë renditet Italia me 120 milionë euro, një dyfishim i vlerës së investuar nga viti i kaluar.



Vijon trendi në rritje i eksporteve të bimëve aromatike

Shqipëria ka një traditë të hershme në prodhimin dhe eksportin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Më shumë se 95% e totalit të bimëve të mbledhura eksportohen.

3/4 e sherebelës së importuar nga SHBA është me origjinë nga Shqipëria.

Në periudhën janar-maj 2020 vlera e eksportit të bimëve medicinale ishte rreth 1.7 miliardë lekë, duke ruajtur trendin në rritje.





ANKETIM

Anketimi i AIDA-s mbi efektet e pandemisë COVID-19 për periudhën Prill-Maj 2020 në kompanitë shqiptare dhe ato të huaja

Pyetësi "Ndikimi i Covid-19 mbi bizneset në Shqipëri" u implementua nëpërmjet kontributit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Ky pyetësor synoi të përcaktonte situatën e krijuar si rezultat i COVID-19, ndaj bizneseve të huaja dhe vendase në Shqipëri me qarkullim vjetor <14 milionë lekë dhe >14 milionë lekë. Këto biznese u ndihmuan drejtpërdrejt dhe u pyetën përmes bisedave telefonike në lidhje me mënyrën se si ata po menaxhojnë situatën, problemet e hasura, si dhe mbledhjen e rekomandimeve që ata mund të kenë për pushtetin qendror dhe vendor.

Kompanitë e anketuara përfaqësojnë sektorë të industrisë prodhuese dhe përpunuese (fason), të tilla si tekstile, lëkurë, këpucë, automotive, agro-përpunim, miniera, sektori i shërbimeve, TIK, telekomunikacion, turizëm, etj. Gjithsej u anketuan 200 kompani prej të cilave 118 ishin kompani të huaja dhe 82 kompani shqiptare.



50 kompani në fushën ICT
65 kompani në industrinë përpunuese
11 kompani në agropërpunim
10 kompani në turizëm

NDIKIMI NË BIZNES


NUK MUND TA PARASHIKONIN
SITUATËN



RAPORTUAN ULJE
ME VLERË NGA 5% - 20%



RAPORTUAN ULJE
MË TË LARTË SE 20%




PROBLEMATIKAT

41 POHUAN MUNGESË LIKUIDITETI
95 POHUAN MUNGESË KLIENTËSH


38 POHUAN VËSHITRËSI ME PAGAT
33 POHUAN RRIJJE TË KOSTOVE

MASAT E MARRA NGA BIZNESI

NUK KANË SHKURTUAR
PUNONJËS



KANË LEJUAR PUNËN
NGA SHTËPIA



KANË APLIKUAR
LEJEN VJETORE



MASAT E MARRA NGA QEVERIA

- ✓ GARANCIA SOVRANE I DHE II
- ✓ RISKEDULIM I TATIM FITIMIT
- ✓ DORËZIMI I BILANCIT NË 31.07.2020

Ndikimi i COVID-19 ne turizmin Shqiptar dhe Evropian



Pandemia e koronavirusit (COVID-19) ka shkaktuar një krizë në ekonominë e turizmit, duke patur parasysh tronditjen e menjëhershme dhe të jashtëzakonshme për sektorin. Vlerësimet e rishikuara të OECD mbi ndikimin COVID-19 tregojnë një rënie në 60% të turizmit ndërkombëtar në vitin 2020. Kjo mund të rritet në 80% nëse rikuperimi vonohet deri në dhjetor. Turizmi ndërkombëtar brenda rajoneve specifike gjeografike (p.sh. Në Bashkimin Evropian) pritet të rikthehet së pari. Turizmi i brendshëm, i cili zë rreth 75% të ekonomisë së turizmit në vendet e OECD, pritet të rikuperohet më shpejt.

Maji dhe Qershori duket se janë muaj rimëkëmbjeje për industrinë e udhëtimeve në Evropë. Të gjithë ne jemi shumë të njohur me imazhet e shumta të njerëzve të cilët kanë bllokuar planet e të ardhmes kudo. Por, sezoni veror ka ardhur dhe njerëzit nuk mund të qëndrojnë më në shtepi sepse pas qëndrimit të gjatë të izolimit deri në dy muaj, mezi presin të udhëtojnë sërish. Sipas statistikave të INSTAT hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Prill 2020, janë 25.257 në total. Krahasuar me Prill 2019, ky tregues rezulton me rënie 97,1 %. Në Prill 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 12.188 në total. Krahasuar me Prill 2019, ky numër ka rënë me 97,0 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë përgjatë katër muajve të parë 2020 është 585.911, duke rënë me 47,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Përgjatë katër muajve të parë 2020, Anglia ka rënie më të vogël të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri, me 30,0 %, ndërsa rënie më të madhe e ka pasur Polonia me 73,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Një rikuperim i plotë i turizmit mund të zgjasë një kohë shumë më të gjatë nga sa shpresonin ose vlerësuan njerëzit, mund të zgjasë përtej fundit të vitit 2020 dhe nuk pritet që jeta të kthehet në normalitet, të paktën 6 muaj pasi virusi të jetë nën kontroll. Ndërsa Evropa rihap dhe punon për të përmirësuar ekonomitë e saj unike të turizmit, ajo po hyn në një fazë të re të planifikimit të rimëkëmbjes, duke sjellë nevojën për bashkëpunim midis drejtuesve dhe një transparencë të ideve më të mira ndër-sektoriale në turizëm. Sikurse në të gjithë botën përhapja e pandemisë së COVID-19 ka goditur masivisht sektorin e turizmit, edhe në Shqipëri bizneset po vuajnë shumë për rimëkëmbjen e vendit. Sipas sipërmarrësve të agjencive turistike në vend vështirësitë kanë filluar që prej muajit shkurt kur nisën vonesat dhe anulimet e para të fluturimeve në Europë dhe në botë, me fillimin e përhapjes së virusit.

Bazuar në supozimin se përhapja e COVID19 do të vihet nën kontroll nga mesi i vitit 2020 — duke mundësuar rinisjen e aktivitetit ekonomik pas heqjes së masave kufizuese për të kontrolluar përhapjen e virusit dhe lehtësimin të tregut financiar dhe ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit - rritja e PBB-së reale për gjithë vitin do të binte me 3.1 %. Për shkak se struktura e tyre ekonomike varet nga eksportet e shërbimeve dhe nga dobësitë fiskale dhe të jashtme, Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova do të përjetonin goditje më të fortë, me një rënie prej mbi 8 pikë % (pp) krahasuar me parashikimet para-COVID-19 2020. Ekonomitë e tyre parashikohet të kontrahohen me rreth 5 %. BH, Serbia dhe Maqedonia e Veriut pritet të përjetojnë recesione disi më të lehta me rënie prej 3.2, 2.5, dhe 1.4 % krahasuar me parashikimet e para COVID-19. Recesioni do të jetë veçanërisht i rëndë në Malin e Zi, Shqipëri dhe Kosovë për shkak të varësisë së tyre nga turizmi. Në nivel global, sipas supozimit të fundit të UNWTO, rënia në numrin e turistëve ndërkombëtarë mund të arrijë deri në 30 %, shumë më e lartë se rënia globale prej 4 % e shënuar në vitin 2009. Sipas skenarit bazë, Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi do përjetojnë rënie me 20-35 % të ardhurave nga turizmi për vitin 2020, dhe kjo do ketë impakt negativ të ndjeshëm në rritjen ekonomike të tyre në vitin 2020 për shkak se për të tre vendet, të ardhurat e drejtpërdrejta dhe indirekte të turizmit vlerësohet se përbëjnë 15 deri më shumë se 25 % të PBB-së. Rimëkëmbja ekonomike në transport dhe turizëm gjithashtu pritet të jetë më graduale, kështu që rritja gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk do të kompensojë humbjet e sezonit të verës. Vetëm turizmi kosovar mund të rifillojë më shpejt pas lehtësimit të kufizimeve të udhëtimit, pasi 80 % e eksporteve të shërbimit të tij të udhëtimit nxiten nga turizmi i diasporës.

Masat globale dhe kombëtare të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit, nga distancimi social deri në mbylljet e biznesit, krijojnë ndërprerje në anën e ofertës dhe zvogëlojnë të ardhurat dhe konsumin e familjeve - një goditje e dyfishtë kërkesë ofertë. Për aq kohë sa kufizimet në udhëtim dhe masat për distancimin social të jenë ende prezente, ndikimi negativ mund të zgjasë më shumë në sektorin e shërbimeve, i cili ka një kontribut veçanërisht të lartë në nivelin e përgjithshëm të punësimit në rajon - 75 % në Mal të Zi dhe rreth 50 % në vendet e tjera.

Gjatë periudhës afatmesme, rritja ekonomike pritet të rikthehet fuqishëm në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor pasi jeta dhe aktiviteti ekonomik gradualisht rikthehen në normalitet, megjithëse shpejtësia e rikuperimit do varet nga kohëzgjatja dhe intensiteti i pandemisë. Në vitin 2021, normat e rritjes ekonomike pritet të rikthehen në nivelet para-COVID-19, përveç në Shqipëri, ku ajo mund të kapërcejë në 8.8 %, dhe në Kosovë, duke u forcuar në 5.2 %. Pritshmëritë janë për një rikthim të besimit të konsumatorëve dhe investitorëve duke rritur konsumin dhe investimet private. Rimëkëmbja në investime dhe aktivitetin në sektorë jetik si shërbime, turizëm, ndërtim dhe energji, do të mbështesin krijimin e vendeve të punës. Në Shqipëri, rindërtimi do të jetë thelbësor për të stimuluar ekonominë në vitin 2021. Për Maqedoninë e Veriut, pranimi i saj kohët e fundit në NATO dhe ftesa zyrtare e Këshillit të BE-së për të hapur negociatat për anëtarësimin në BE (së bashku me Shqipërinë) duhet të ndihmojnë në përshejtimin e rimëkëmbjes. Megjithatë, rikthimi i pritshëm i aktivitetit ekonomik bazohet në supozimin se përhapja e pandemisë do të zbehet në mënyrë efektive në gjysmën e dytë të vitit 2020.

Ndikimi i krizës po ndihet në të gjithë ekosistemin e turizmit, rihapja dhe rimëkëmbja e destinacioneve do të kërkojë një qasje të bashkuar. Bizneset dhe punonjësitë e turizmit po përfitojnë nga paketat stimuluese në të gjithë ekonominë, nga qeveritë përkatëse gjithashtu duke prezantuar masa specifike për turizmin. Qeveritë dhe industria e këtyre vendeve po përqëndrojnë përpjekjet e tyre në:

- Heqjen e kufizimeve të udhëtimit dhe puna me bizneset për të hyrë në mbështetje të likuiditetit dhe aplikimi i protokolleve të reja shëndetësore për lëvizshmërinë.
- Rivendosja e besimit të udhëtarëve dhe stimulimi i kërkesës, aplikacionet e informacionit për vizitorët dhe fushatat vendase të promovimit të turizmit.
- Përgatitja e planeve gjithëpërfshirëse të rimëkëmbjes së turizmit, për të rimëkëmbur destinacionet, për të inkurajuar inovacionin dhe investimet dhe për të rimenduar sektorin e turizmit.
- Industria e udhëtimit dhe turizmit dhe qeveritë duhet të vazhdojnë të forcojnë mekanizmat e tyre të koordinimit për të ndihmuar bizneset, veçanërisht ato më të vogla.

Duke parë nga e ardhmja, masat e vendosura sot do të krijojnë turizmin e së nesërme. Qeveritë duhet të marrin në konsideratë problematikat afatgjata të krizës, duke qëndruar përpara kurbës dixhitale, duke mbështetur tranzicionin e ulët dhe duke promovuar transformimin strukturor të nevojshëm për të ndërtuar një ekonomi të fortë, më të qëndrueshme dhe elastike të turizmit. Kriza është një mundësi për të rimenduar turizmin për të ardhmen. Turizmi është një pjesë e konsiderueshme e shumë ekonomive kombëtare, dhe tronditja e menjëhershme dhe e jashtëzakonshme për sektorin e turizmit që rezulton nga pandemia e koronavirusit po ndikon në ekonominë më të gjerë.





invest in Albania

